




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.63/2024
Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në takimin 322-të, të mbajtur më 7 mars 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e kryetares së Komisionit për Çështje Normative për lirimin e gjyqtarit Qerim Ademaj, nga trajtimi i lëndëve në Gjykatën e Apelit, deri me 31 korrik 2024.
- II. Z. Ademaj, gjatë kësaj periudhe do të angazhohet me orar të plotë në Komisionin për Çështje Normative dhe pas përfundimit do t'i kthehet shërbimit si gjyqtar në trajtimin e lëndëve në Gjykatën e Apelit.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga Kryetarja e Komisionit për Çështje Normative ka pranuar kërkesë për lirimin e gjyqtarit Qerim Ademaj nga trajtimi i lëndëve në Gjykatën e Apelit, me qëllim të angazhimit të tij në Komisionin për Çështje Normative. Tutje në kërkesë ka theksuar se duke pasur parasysh planin e punës së komisionit të miratuar për vitin 2024 dhe angazhimin e komisionit në hartimin e akteve të tjera, si rrjedhojë e kërkesave ligjore të rëndësishme për gjyqësorin, e posaçërisht disa prej të cilave edhe me prioritet është paraqitur nevoja që anëtarët e komisionit të kenë angazhim të plotë në punën e komisionit.

Këshilli, pas shqyrtimit të kërkesës dhe me qëllim të realizimit të objektivave të KGJK-së dhe përmbushjen e përgjegjësive si anëtar të Këshillit, ka konsideruar të nevojshme të liroj gjyqtarin Qerim Ademaj nga trajtimi i lëndëve në Gjykatën e Apelit dhe i njëjti të angazhohet në punën e tij si anëtar i KÇN-së. Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Qerim Ademaj, anëtar i KGJK-së;
- Kryetares së Komisionit për Çështje Normative;
- Gjykatës së Apelit
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Arkivit të KGJK-së.